<table>
<tr><th colspan="2">NJOFTIM PUNËSIMI</th></tr>
<tr><td>Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK</td><td>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.<br>Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për <u>një vend pune</u>:Inspektor pranë Sektorit Menaxhimit Debive në Njësinë Operative Durrës nisur nga data më e afërt.Punëmarrësi i ri evidenton dhe raporton mbi gjendjen e matësave si mungesa e vulave, ndërhyrje të paligjshme dhe të pa autorizuara në matës, probleme funksionale të matësit, etj.</td></tr>
<tr><td>Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:</td><td><ul>
<li>Evidenton dhe raporton mbi konsumatorët pa matëse.</li>
<li>Evidenton dhe raporton për mospërputhje të leximit në sistem me atë faktik, kur i kërkohet.</li>
<li>Evidenton dhe raporton mbi moszbatimin e detyrave nga punonjës të tjerë, sa i përket lidhjeve në rrjet.</li>
<li>Evidenton dhe raporton mbi moszbatimin e ligjshmërisë dhe/në lidhje me konsumatorin.</li>
<li>Evidenton dhe raporton çdo lloj forme abuzimi në rrjetin furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.</li>
<li>Kryen njoftimet përkatëse të klientëve debitor sipas listave të dërguara nga Sektori i Menaxhimit të Debive pranë Drejtorisë së Përgjithshme dhe mban përgjegjësi personale për moszbatimin në kohë të njoftimeve.</li>
<li>Kryen verifikime sipas udhëzimeve të Drejtuesit Grupit.</li>
<li>Mbështet dhe merr pjesë aktivisht në kryerjen e inspektimeve nga Drejtoria e UPA e Drejtorisë së Përgjithshme duke u vënë në dispozicion të saj si dhe duke zbatuar udhëzimet e saj.</li>
</ul></td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | • Mbështet dhe merr pjesë aktivisht në të gjitha fushatat e ndërgjegjësimit për zbatimin e detyrimeve ligjore të konsumatorëve ndaj Shoqërisë dhe në plotësimin e Formularëve për përditësimin e të dhënave të konsumatorëve.<br><br>• Përfshihet në mënyrë aktive në sqarimin e ankesave të konsumatorëve, duke bashkërenduar me strukturat e Degës së Shitjes në NjO, si dhe Drejtorisë së Shitjes dhe Drejtorisë së Shërbimit të Klientit në Drejtorinë e Përgjithshme si dhe duke zbatuar udhëzimet e tyre. |
| **Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:** | • Eksperienca pune të mëparshme.<br>• Librezë e Punës<br>• Certifikatë Familjare<br>• Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës<br>• Dy fotografi<br>• Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar<br>• Dëshmi Penaliteti<br>• Raporti Mjekësor<br>• Vërtetim Vendbanimi |
| **Kushtet e punës:** | • Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur.<br>• Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani. |

- Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 25.06.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.